



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 159/1 prot.

Tiranë më 5.2 2018

Lënda: Mbi kërkesën për mendim lidhur me informacionin e kërkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

VODAFONE ALBANIA SH.A

Për dijeni: **KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si institucion shtetëror i pavarur, ushtron veprimtarinë në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" dhe ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Ndër detyrat kryesore të institucionit është mbikëqyrja dhe monitorimi i mbrojtjes së të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit ka marrë në shqyrtim kërkesën tuaj për opinion me referencë LEA/005/IL dhe administruar pranë nesh me nr. 159 prot., datë 24.01.2018 lidhur me informacionin e kërkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në lidhje me një pajtimtar të Vodafone Albania sh.a, i cili është njëkohësisht subjekt rivlerësimi në zbatim të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Pas verifikimit të bazës ligjore dhe fakteve të evidentuara në të, në zbatim të akteve normative në fuqi dhe ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Zyra e Komisionerit vlerëson se kontrolluesit që përpunojnë të dhëna personale duhet të respektojnë në çdo rast parashikimet e neneve 5 dhe 6 të ligjit specifik të sipërcituar, në lidhje me komunikimin e të dhënave personale tek palët e treta.

Sa më sipër në nenin 6/1/ç/d "Kriteret ligjore të përpunimit" përcaktohet përpunimi i të dhënave personale., ç) *për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit; d) për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik.*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si ligji themelor, në nenin Ç, pika 4 *Rivlerësimi* të Aneksit të saj, përcakton se organet e rivlerësimit në kuadër të përmbushjes së detyrave të tyre mund të urdhërojnë individë dhe **shoqëri tregtare** të japin prova në përputhje me ligjin.

4.Komisioni ose Kolegji mund të urdhërojë individë dhe **shoqëri tregtare** të dëshmojnë ose të japin prova në përputhje me ligjin.

Normat për ndërhyrje të justifikueshme në të dhënat personale në frymën edhe të legjislacionit ndërkombëtar janë të lejueshme dhe respektimi i privatësisë duhet ekuilibruar dhe përputhur me interesa të tjerë legjitimë, qofshin ato të personave të tjerë (interesa privatë) apo të shoqërisë në tërësi (interesa publikë). Kufizimet rrjedhimisht në ushtrimin e së drejtës për mbrojtje të të dhënave personale, sikurse përpunimi i të dhënave personale, janë të pranueshme nëse janë të parashikuara në ligj (Kushtetuta rasti konkret), me kusht respektimin e proporcionalitetit dhe nëse përputhen **me objektivat e interesit të përgjithshëm publik**.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si akti normativ më i rëndësishëm në hierarkinë e akteve, në nenin A të aneksit të saj parashikon kufizimin e të drejtave të subjekteve që i nënshtrohen rivlerësimit, ku parashikohet se: *1. Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, vecanërisht i neneve që lidhen me respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37....kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës.*

Në të njëjtën kohë, organet e rivlerësimit janë subjekte të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", duke patur detyrimin ligjor të garantojnë transparencën e procesit por edhe gjetjen e balancës së duhur midis transparencës dhe të drejtave të cilat kufizohen, si në rastin konkret. Në këtë kuadër, duhen respektuar rregullat që i përkasin përpunimit të informacionit në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sipas neneve 5, 6, 7, 27, 28 të ligjit nr. 9887 të sipërcituar. Veçanërisht, në rastin konkret informacioni që sigurohet nga subjekte juridike publike dhe privatë duhet të përpunohet në përputhje me qëllimin e mbledhjes, respektimin e mjafueshmërisë dhe proporcionalitetit në lidhje me sasinë e informacionit që kërkohet të vendoset në dispozicion, duke respektuar në çdo rast edhe parashikimet kushtetuese dhe ligjet specifike të dalë në zbatim të tij si ligji 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe pa tejkaluar këto kompetenca.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

